



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. dokumentit: 22.14.1-2011-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË
PRIZRENIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2011

Prishtinë, Qershor 2012

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave.....	4
Përmbledhje e përgjithshme	5
1 Hyrje.....	7
2 Opinioni i auditimit	9
3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar	10
4 Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar	11
5 Pasqyrat financiare – Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësia e informacionit.....	12
6 Menaxhimi Financiar	13
6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake).....	13
6.2 Shpenzimet.....	15
6.3 Pasuritë	19
6.4 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor	20
7 Kontrolli mbi menaxhimin	21
7.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm.....	21
7.2 Auditimi i Brendshëm	22
8 Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Prizrenit.....	23
Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	24
Shtojca II: Rekomandimet e vitit të kaluar	26

Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KA	Komiteti i Auditimit
KBFP	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
LAB	Ligji për Auditimin e Brendshëm
LMFPP	Ligji 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji nr.02/L-99 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar më 8 shkurt 2007. Përfshirë ligjin e ri, Nr. 04/L-042 në fuqi prej 05 tetor 2011.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZKA	Zyrtar Kryesor Administrativ
SKB	Sistemi i Kontrollit të Brendshëm

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, të hartuara nga INTOSAI (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me PVF.

Sipas opinionit tonë PVF në të gjitha aspektet materiale prezantojnë *pamje të drejtë dhe të vërtetë*. (SNISA 400: *Opinion i Pakualifikuar*).

Ne vlerësojmë bashkëpunimin e komunës së Prizrenit me ZAP. Progresi i arritur në adresimin e rekomandimeve të vitit të kaluar nuk ishte i kënaqshëm.

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë përshkruar më gjerësisht në brendi të këtij raporti.

Konkluzioni ynë është se komuna nuk ka arritur të ndërtojë një strukturë të mirë të qeverisjes. Menaxhmenti i komunës duhet të zhvilloj një qëndrim më pozitiv ndaj kontrolleve të brendshme të organizatës.. Kjo do të duhej të adresohet për të përmirësuar performancën e organizatës.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, ne ju rekomandojmë që të siguron:

- Që të gjitha çështjet e ngritura nga auditimi të adresohen dhe të pasohen me masa adekuate të veprimit;
- Përmirësime të mëtutjeshme të performancës buxhetore;
- Planifikim më të mirë dhe forcim të kontrolleve në menaxhimin e të hyrave vetjake;
- Se procedurat e prokurimit zhvillohen konform rregulloreve të prokurimit dhe të forcohen kontrollet e monitorimit të kontratave ;
- Hartimin e një rregullore për dhënie dhe shfrytëzimin e subvencioneve;
- Të përfundoj një regjistër gjithë përfshirës të pronës, objekteve dhe pajisjeve si dhe të njëjtat t'i regjistroj në regjistrat kontabël dhe të pasurisë; dhe
- Se një rishikim funksional i kontrolleve të brendshme do të bëhet dhe roli i auditimit të brendshëm do të fuqizohet më shumë.

Menaxhmenti i komunës së Prizrenit është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi PVF për vitin 2011 dhe është zotuar që do të bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me PVF të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e Komunës së Prizrenit të përgatisë PVF sipas kërkesave të Rregullës Financiare Nr. 07/2011 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi kryer auditimin e ndërmjetëm të Komunës së Prizrenit. Gjatë asaj faze të auditimit, kemi adresuar faktin se si janë trajtuar rekomandimet e mëparshme, Pasqyrat Financiare nëntë mujore si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Po ashtu, kemi këshilluar menaxhmentin për adresimin e çështjeve në pasqyra financiare, përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në dhjetor 2011.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive tona për auditimin e Komunës Prizrenit, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar PVF të Komunës së Prizrenit në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2011;
- Kemi përcaktuar nëse PVF janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;

- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi PVF 2011.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për PVF të Komunës së Prizrenit Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën II.

2 Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë PVF në të gjitha aspektet materiale prezantojnë *panje të drejtë dhe të vërtetë*. (SNISA 400: *Opinion i Pakualifikuar*).

3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar

Opinion i për PVF për vitin 2010 ishte *opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*. Theksim i çështjes ishin regjistrat jo të plotë dhe jo të saktë për asetet fikse dhe llogaritë e arkëtueshme.

Për vitin 2010 ishin dhënë 10 rekomandime. Komuna kishte përgatitur planin e adresimit të rekomandimeve. 2 rekomandime janë adresuar plotësisht, ndërsa 8 nuk ishin adresuar.

Kjo shpreh një mungesë të performancës kontrolluese dhe gatishmërinë e menaxhmentit për të ndërmarrë veprime përmirësuese. Këshilla audituese janë dhënë në memon e auditimit për nëntëmujorin e vitit 2011. Përkundër kësaj, menaxhmenti asgjë nuk kishte ndërmarrë. Dhe, derisa veprimet e duhura nuk ndërmerren, mangësitë e theksuara më lartë do të vazhdojnë të ekzistojnë.

Kryetari i komunës dhe menaxherët përgjegjës të fushave të ndryshme ku janë identifikuar dobësitë dhe mangësitë menaxheriale, duhet të diskutojnë një Plan masash të veprimit për të adresuar çështjet e ngritura nga auditimi.

Mos adresimi i plotë i rekomandimeve tona të mëhershme, kanë shkaktuar të njëjtat probleme si në vitet e kaluara. Shprehim shqetësimin tonë për të gjitha rekomandimet e pa implementuara.

4 Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1: Pasqyra e buxhetit, pranimeve dhe shpenzimeve Në euro (€)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Pranimet/ Shpenzimet 2011	Pranimet/ Shpenzimet 2010
Grandi i Qeverisë – Buxheti	26,052,819	26,168,819	26,073,952	21,119,192
Të hyrat vetjake të vitit 2011	5,121,830	5,321,830	4,998,778 ¹	4,434,450
Të hyrat e bartura nga 2010	0	1,458,621	1,458,621	792,641
Donacionet e vendit	0	224,888	224,888	284,122
Donacionet e jashtme	0	476,429	476,429	58,000
I. Gjithsej pranimet dhe transferi i donacioneve	31,174,649	33,650,587	33,232,668	26,688,405
Pagat dhe mëditjet	14,141,119	14,421,864	14,403,387	11,129,125
Mallra dhe shërbime	2,076,942	2,381,734	2,133,270	2,340,381
Shpenzimet Komunale	660,033	660,034	638,218	616,553
Subvencionet dhe transfere	360,979	370,977	351,636	372,004
Investimet Kapitale	13,935,576	15,815,978	14,491,764	10,771,721
Rezervat	0	0	0	0
II. Gjithsej shpenzimet	31,174,649	33,650,587	32,018,275	25,229,784
Diferenca I-II	0	0	1,214,393	1,458,621²

Në bazë të dhënave në tabelën e mësipërme shihet se buxheti final për vitin 2011 ishte 33,650,587€. Shpenzimet për vitin fiskal 2011 ishin 32,018,274€ apo 95% e buxhetit final. Diferenca prej 1,214,393€ është e hyrë vetjake e pashpenzuar në vlerë prej 1,127,998€ dhe donacionet e brendshme dhe të jashtme të pashpenzuara në vlerë 86,395€ të cilat barten për shfrytëzim në vitin 2012.

¹ Të hyrat e mbledhura në vitin 2011

² Të hyrat vetjake të pashpenzuara në fund të vitit 2010. Kjo shumë është bart për shfrytëzim në 2011

Nga tabela shihet se buxheti final ishte për 2,475,938€ më i lartë se buxheti fillestar. Kjo rritje ishte për shkak të grandit të Qeverisë në vlerë prej 116,000€, të dhënë për paga dhe mëditje, të hyrave vetjake në vlerë prej 1,658,621€ dhe donacioneve prej 701,317€.

Ne kemi vërejtur tendencën e rritjes së shpenzimeve të investimeve kapitale në fund të vitit financiar. Rreth 32% të totalit të shpenzimeve për këtë kategori ishin shpenzuar në tremujorin e fundit.

Konkluzioni

Komuna nuk ka arritur ta harmonizoj plotësisht buxhetin me dinamikën e shpenzimeve në periudha kohore. Nga totali i shpenzimeve buxhetore, 32% ishin shpenzuar në tre muajt e fundit. Ne kemi parasysh faktin se Kuvendi kishte pasur vonesa në aprovimin e buxhetit si dhe nuk është bërë fare rishikimi gjysmë vjetor i buxhetit dhe kjo ka paraqitur sfidë të vështirë për të gjithë shpenzuesit buxhetor. Përkundër kësaj, komuna ka realizuar një performancë shumë të mirë në menaxhimin e buxhetit. Me gjithë përqindjen e lartë të ekzekutimit të buxhetit, përmirësime të mëtutjeshme të performancës buxhetore nevojiten edhe më tutje.

Rekomandimi 1

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Forcimin e kontroleve financiare mbi menaxhimin e buxhetit, në veçanti të harmonizoj planin e rrjedhës së parasë me dinamikën e aktiviteteve operative (projekteve kapitale, furnizimet me mallra dhe shërbime) dhe të shqyrtoj në baza të rregullta ndryshimet në zërat buxhetor, duke analizuar të gjitha shmangiet nga objektivat e planifikuara.

5 Pasqyrat financiare – Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit

Draft Pasqyrat Financiare Vjetore të komunës të përgatitura më 31.01.2012 për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2011 nuk ishin në pajtim me Rregullën Financiare nr. 07/2011. Ato ishin jo të plota dhe të pasakta, prandaj ne gjatë procesit të auditimit kemi kërkuar nga Komuna që Draft PVF të korrigjohen. PVF të komunës pas kërkesës sonë janë korrigjuar dhe dërguar për herë të dytë në Thesar, mirëpo prapë disa gabime kanë mbetur të pa korrigjuara në PVF finale. Mangësitë e PVF janë:

- Pagesa nga palët e treta të jashtme në vlerë prej 6,430€ nuk ishte shpalosur.

Kërkesat e LMFP nr. 03/L-048 dhe Rregullës Financiare nr.07/2011.

- Komuna ka përgatitur PVF sipas Rregullës Financiare nr. 07/2011 mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore;
- PVF janë nënshkruar brenda kornizës kohore me datën 29/01/2012 dhe janë dorëzuar në MF;
- PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore;
- PVF janë pranuar vetëm në gjuhën shqipe;
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Ministri i Financave gjatë vitit 2011.

Konkluzioni

Me përjashtim të mangësisë të cekur më lartë, e cila nuk ka ndikim material, pasqyrat financiare të Komunës, në përgjithësi ofrojnë informata në pajtim me rregullat e raportimit financiar në bazë të kontabilitetit sipas parasë së gatshme.

6 Menaxhimi Financiar

6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin fiskal 2011 ishin 5,321,830€, kurse gjatë kësaj periudhe janë inkasuar 4,998,778€. Plani vjetor i mbledhjes së të hyrave ishte realizuar 94%.

Ne kemi bërë disa ekzaminime mbi zbatimin e procedurave për regjistrim dhe mbledhjen e të hyrave dhe kemi identifikuar si më poshtë:

Ripërtirja e kontratës pa u inkasuar borxhet e mëhershme

Komuna më datën 01/03/2011 ka ripërtirë një kontratë qiraje me operatorin "Sharbegu" për shfrytëzimin e pronës publike për një periudhe njëvjeçare. Qiraja mujore ishte caktuar 800€ për muaj. Kontrata ishte ripërtirë, edhe pse qiramarrësi sipas kushteve të kontratës, nuk kishte paguar shumën e mbetur nga kontrata e vjetër prej 3,201€.

Mungesa e regjistrave të plotë për të hyrat vetjake

Te drejtoria për pronë kemi vërejtur se mban një evidencë për qiramarrësit e lokaleve të komunës, por regjistrat ekzistues nuk përmbajnë të dhënat për kohën kur është bërë faturimi dhe inkasimi i të hyrave.

Regjistrimi në kodet e gabuara

Gjatë testimit kemi gjetur se të hyrat nga çertifikatat e lindjes nuk ishin regjistruar sipas kodit përkatës ekonomik.

Regjistrimi i bizneseve të reja pa likuidimin e borxheve të mbetura

Ne kemi identifikuar 5 raste të bizneseve të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në komunën e Prizrenit nuk i përgjigjen dhe nuk paguajnë borxhet e mbetura. Shqetësimi ynë ishte se komuna, përkatësisht qendra për regjistrimin e bizneseve, i lejon këto biznese të regjistrojnë biznese të reja pa kurrfarë ndalese dhe pa kurrfarë kërkesë për likuidimin e borxheve të vjetra.

Konkluzioni

Komuna nuk ka vendosur mekanizmat e duhur të kontrollit mbi të hyrat vetjake. Mungesa e evidencave të qarta dhe të mjaftueshme për të gjitha llojet e të hyrave ka si rezultat informacionet jo të sakta dhe të besueshme për të hyrat. Regjistrimi i të hyrave në kodet jo përkatëse ka si pasojë raportimin e gabueshëm të tyre.

Ekziston një rritje të të hyrave vetjake të komunës për 13% më shumë se në vitin paraprak. Çështja e të hyrave mbetet një nga sfidat kryesore të menaxhmentit. Në strukturën e buxhetit total të komunës, të hyrat vetjake marrin pjesë me 15%. Per shkak të numrit të madh të bizneseve që operojnë në komunën e Prizrenit si dhe numrin e madh të qytetarëve që paguajnë taksa komunale, menaxhmenti i komunës duhet t'i rishikoj politikat dhe planet për një shkallë më të lartë të inkasimit.

Rekomandimi 2

Ne rekomandojmë Kryetarin që të siguroj që:

- Të mos lidhë kontratë me borxhlinjtë të cilët kanë borxhe ndaj Komunës;
- Të rrisë kontrollet e inspektimit për të gjithë bizneset të cilët nuk i përgjigjen pagesave të borxhit, të ndërmerren masat ndëshkuese për të gjithë bizneset që kundërshtojnë pagesën e tarifave mbi ngarkesa komunale;
- Të siguroj se regjistrimi i të gjitha të hyrave do të bëhet sipas kodeve përkatëse; dhe
- Të azhurnoj të gjithë regjistrat e obliguesve (bizneseve dhe personave fizik) të taksave komunale sipas të gjitha bazave të ngarkesës, t'i pasuroj regjistrat me të dhënat e duhura dhe të forcoj kontrollet e inkasimit sipas periudhave kohore.

6.2 Shpenzimet

6.2.1 Prokurimi

Ne kemi testuar 60 mostra që mbulojnë 6,308,885€ të pagesave të shpenzimeve përmes procedurave të prokurimit. Ne kemi vërejtur se në 17 mostra komuna ka ndërmarrë procedurat e prokurimit të cilat nuk janë në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik:

Kjo përshkruhet nga shembujt e më poshtëm:

Furnizimet janë kryer para se të zhvillohen procedurat e prokurimit

Te kontrata e lidhur më datën 29/04/2011 - Furnizim me artikuj ushqimor për invalidët e luftës, kemi vërejtur se së pari janë pranuar artikujt ushqimor, ndërsa procedurat e prokurimit janë kryer më vonë. Vlera e kontraktuar dhe e shpenzuar për këto artikuj ushqimor ishte 13,642€. Furnizuesi i artikujve ushqimor ishte DPT "Mak Pilar".

Rasti i dytë i furnizimeve me dy artikuj ushqimor në shumë prej 36,600€ ishte bërë gjatë vitit 2010 për nder të festës së Bajramit, derisa procedurat e prokurimit ishin zhvilluar gjatë vitit 2011. Në këtë rast furnizuesi ishte Shpk "Benaf".

Në një rast tjetër, ishte lidhur kontratë me 21/03/2011 në shumë prej 9,767€ në emër të dekorimit të qytetit për fundvitin 2010. Ne kemi vërejtur se komisioni pranimin e punëve e ka bërë më datën 07/04/2011.

Mos arsyetimi i shërbimeve profesionale të konsulencës

Gjatë vitit 2011 komuna kishte lidhur me një kompani private katër kontrata për t'i ofruar shërbime profesionale të konsulencës në ofrimin e praktikantëve në komunë, në vlerë prej 48,630€. Mirëpo edhe pse pagesa ishte bërë për ofrimin e shërbimeve profesionale të konsulencës, ne nuk na është ofruar asnjë dëshmi se kujt ju kanë ofruar këto shërbime.

Mungesë e ofertuesve të përgjegjshëm

Tek kontrata e lidhur më datën 29/04/2011 'Furnizim me dru ahu''e ndarë në pesë lote në vlerë totale 165,252€, asnjëri nga katër operatorët ekonomik konkurrues sa ishin gjithsej pjesëmarrës në tender, nuk i kishte plotësuar kriteret administrative të vendosura nga Autoriteti Kontraktues.

Po ashtu, tek kontrata e lidhur më datën 13/09/2011 në vlerë prej 51,083€ "Ngritja e dhjetë serrave bujqësore në Prizren" asnjë nga ofertuesit nuk i ka plotësuar kriteret administrative për aplikim për tender të vendosura nga Autoriteti Kontraktues, dëshmi mbi qarkullimin financiar për 3 vitet e fundit.

Nënshkrimi i kontratave pa Zotim të mjaftueshëm të fondeve

Tek projekti "Ndërtimi i rrugës dhe trotuareve në fshatin Legjendë" është lidhur kontratë me operatorin ekonomik në shumë prej 193,503 €, ndërsa për këtë projekt ishin zotuar vetëm 6,550€. Pothuajse shumica e kontratave për punë, ishin lidhur pa zotim të mjaftueshëm të fondeve.

Pranimi i punëve nga zyrtarët e njëjtë

Ne kemi vërejtur se për çdo projekt kapital është caktuar organi mbikëqyrës, i cili përveç përcjelljes së punimeve, në terren ishte edhe anëtar komisioni për pranim teknik të punimeve.

Mos aplikimi i ndëshkimeve për shkak të mos liferimit të mallrave në afatin e paraparë dhe kryerjes së punëve sipas kontratës

Kontrata për "Furnizimi me material ndërtimor për ndërtimin e nëntë (9) shtallave" ishte nënshkruar më datën 13/04/11. Sipas planit dinamik, mallrat do të duhej të pranoheshin më së largu deri më datën 25/05/11. Ndërsa një pjesë e mallrave janë pranuar me datën 07/06/11 në vlerë prej 10,000€, me 13 ditë vonesë, dhe një pjesë tjetër janë pranuar me datën 04/07/11 në vlerë prej 9,955€, me 40 ditë vonesë.

Ne kemi vërejtur se shumica e projekteve të cilat kishin filluar gjatë vitit 2010, ishin përfunduar gjatë vitit 2011. Për këto vonesa në asnjë rast komuna nuk ka aplikuar penale apo ndëshkime tjera.

Konkluzioni

Rastet e përshkruara me lartë flasin për mangësi të kontrollit të aktiviteteve. Me sa duket, disa nga proceset nuk janë të definuara mirë, si: mbikëqyrja e proceseve, ndarja e detyrave dhe verifikimi. Mungesa e rregullave të brendshme dhe politikave si dhe gabimet në udhëheqjen e procedurave kanë shkaktuar këto dështime edhe në procedurat e kontrollit.

Zhvillimi i procedurave të prokurimit, pasi aktivitetet të jenë kryer, është një praktikë që nuk njihet nga ligji dhe si e tillë nuk duhet të ndodhë. Gjithashtu, kryerja e pagesave pa arritjen e objektivave të kontratës, flet për një performancë të keqe financiare.

Dhe, të qenit e organit mbikëqyrës edhe anëtar komisioni për pranim teknik të punëve, paraqet në vete një ndarje jo të mirë të detyrave dhe lë hapësirë që ndikimi i organit mbikëqyrës të vie në shprehje edhe nëse kanë ndodhur gabime në realizimin e projektit.

Rekomandimi 3

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Procedurat e prokurimit të fillohen me kohë dhe në pajtim me kërkesat ligjore, dhe jo së pari të kryhen punët apo furnizimet, e pastaj të zhvillohen procedurat formale. Gjithashtu, asnjë kontratë të mos bëhet me operatorët që nuk përmbushin kriteret ligjore;
- Të gjitha pagesat të bëhen në pajtim me kërkesat e kontratës dhe vetëm pasi të jenë bërë verifikimet e duhura se mallrat/shërbimet e kontraktuara janë pranuar në sasinë dhe cilësinë e duhur;
- Të gjitha projektet e filluara kanë fonde të mjaftueshme financiare për t'u përfunduar;
- Se për të gjitha vonesat në realizimin e projekteve të aplikoj penale sipas kontratës;
- Të bëhet një ndarje më e qartë e detyrave për t'u shmangur konflikti i interesit.

6.2.2 Kompenzimet (pagat dhe mëditjet)

Buxheti i ndarë për paga dhe mëditje ka qenë 14,421,864€, ndërsa gjatë kësaj periudhën janë shpenzuar 14,403,386€. Për të testuar se si kanë funksionuar pagesat për paga dhe procedurat e rekrutimit të personelit, ne kemi përzgjedhur 39 mostra dhe kemi gjetur parregullsitë në vijim:

- Komuna nuk ka arritur të krijoj regjistrin e dosjeve elektronike të nëpunëseve civil;
- Në 13 dosje të punësuarve në arsim mungojnë përshkrimi i punëve, forma e aprovimit të pushimit vjetor dhe formularët për vlerësim vjetor të punës, dokumentet e identifikimit dhe llogaritë bankare;
- Në dosjen e një të punësuarit mungon kontrata e punës për vitin 2011;
- Në dosjet e gjashtë të punësuarve nuk është e cekur paga bazë në kontratë;dhe
- Në dosjet e të rekrutuarve të rijnë mungon dokumentacioni përkatës i cili dëshmon përcaktimin e kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë.

Konkluzioni

Nga dobësitë e përmendura, shihet se komuna duhet të përmirësoj menaxhimin e burimeve njerëzore, për faktin se dosjet nuk janë të strukturuar mirë dhe të kompletuar me dokumentacionin e nevojshëm.

Rekomandimi 4

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Regjistër elektronik të dosjeve të nëpunëseve civil me të dhëna të nevojshme në pajtim me Rregulloren Nr.03/2011;
- Se dosjet e zyrtarëve janë azhurnuar me të gjitha të dhënat e duhura, se vlerësimi i punëtorëve kryhet në baza të rregullta, përshkrimi i punëve dhe formulari i pushimeve vjetore të sistemohen në dosjen personale të zyrtarëve; dhe
- Se çdo i punësuar posedon kontratë pune, në të cilën përcaktohet paga bazë. Në të kundërtën do të hiqet nga lista e pagave.

6.2.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti i ndarë për subvencione dhe transfere ka qenë 370,977€ ndërsa shpenzimet 351,635€ apo 95 %.

Ne kemi testuar 16 mostra në vlerë prej 154,420€ në kategorinë e subvencioneve dhe transfere, dhe kemi vërejtur se Komuna e Prizrenit nuk ka një rregullore të brendshme për ndarjen e subvencioneve që i përcakton qartë procedurat dhe kriteret për përfitimin e këtyre mjeteve. Si rezultat i kësaj ne kemi gjetur parregullsitë si në vijim:

Shpërndarja e subvencioneve pa kritere të përcaktuara për përfituesit

Me rastin e subvencionimit me material ndërtimor për ndërtimin e shtallave, kontrata është lidhur me 13.04.2011 në vlerë prej 29,955€, komuna nuk ka përcaktuar kriteret për përfituesit. Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur se sasia e materialeve të përfituara ndryshon për përfitues të ndryshëm. Si shembull, ka përfitues që kanë marr nga 1000 blloka ndërtimi, mirëpo ka edhe përfitues me nga 1500 blloka ndërtimi.

Konkluzioni

Komuna nuk ka ndonjë rregullore të veçantë për qëllimet dhe procedurat e dhënies së subvencioneve. Mungesa e një rregullore të tillë rrit rrezikun që paraja publike të mos shpenzohet për qëllimet e duhura.

Dhënia e subvencioneve nga komuna, duke mos përcaktuar fillimisht kriteret mbi bazën e të cilave do të bëhej selektimi i përfituesve, paraqet një rrezik që fondet e dedikuara në formë subvencionesh të mos u jenë adresuar personave në nevojë.

Po ashtu, mungesa e kontrolleve mbikëqyrëse mbi shpenzimet e bëra, shton rrezikun që mjetet të mos shfrytëzohen në pajtim me ndarjet.

Rekomandimi 5

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Miratimin e rregullores së brendshme që do të përcaktonte kriteret dhe procedurat e qarta gjatë ndarjes së subvencioneve dhe transfereve; dhe
- Se çdo përfitues të jetë i kompletuar me dokumentacion dhe të raportoj në Departamentet përkatëse të Komunës mbi shpenzimet e mjeteve sipas kërkesës dhe projekteve të ofruara.

6.3 Pasuritë

Komuna e Prizrenit posedon një regjistër të pasurive, por regjistri nuk është azhurnuar me ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, dhe si i tillë nuk është i plotë dhe gjithëpërfshirës për vitin 2011.

Gjatë ekzaminimit të pasurive, kemi vërejtur se Kryetari i Komunës ka formuar tri komisione: për inventarizim të pajisjeve, për vlerësim të pasurive dhe për menaxhimin e aseteve komunale, mirëpo kjo çështje është në proces dhe nuk ne nuk na janë ofruar raporte mbi punën e kryer nga ana e këtyre komisioneve. Një raport për inventarizim

është përfunduar, por jo në afatin e rregullt kohor, gjë që nuk janë bërë plotësimet në regjistrat kontabël të pasurive sipas gjendjes së raportit të përfunduar.

Konkluzioni

Komuna nuk i ka menaxhuar pasuritë e saj në pajtim me Udhëzimin administrativ nr.21/2009 për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive qeveritare. Komuna nuk kishte bërë regjistrimet e duhura të fundvitit, për të krahasuar gjendjen kontabël me gjendjen faktike të pasurive Regjistri aktual nuk ofron pasqyrë të plotë të pasurive me të cilat posedon komuna, dhe si rrjedhojë nuk mund të konfirmohet ekzistenca fizike e pasurive.

Gjendje e njejtë me pasuritë ishte edhe vitin e kaluar dhe menaxhmenti i komunës nuk ka marrë ndonjë veprim për ta përmirësuar gjendjen, prandaj ne do të përsërisim rekomandimin e dhënë më parë.

Rekomandimi 6

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Të përfundoj një regjistër gjithë përfshirës të pronës, objekteve dhe pajisjeve si dhe të njëjtat të regjistroj dhe të shpalos në pasqyrat financiare të vitit vijues; dhe
- Të kryejë numërimin e rregullt fizik për tu siguruar mbi ekzistencën dhe të barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe regjistrin të pasurisë.

6.4 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor

Komuna e Prizrenit kishte dorëzuar:

- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Planin e prokurimit me kohë;
- Raportet mbi borxhet e dorëzuar në MF;dhe
- Planin e adresimit të rekomandimeve.

7 Kontrolli mbi menaxhimin

7.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Komuna akoma nuk ka ndërtuar një sistem efektiv të kontrollit të brendshëm. Menaxhmenti nuk inkurajon vendosjen dhe forcimin e kontrolleve të brendshme. Dështimi në zbatimin e rekomandimeve, këtë konkluzion e përshkruan më së miri. Politikat e kontabilitetit dhe vlerësimeve nuk janë përcaktuar si duhet. Kjo vërehet sidomos tek të hyrat dhe menaxhimi i pasurive. Komuna nuk ka politika të veçanta për identifikimin dhe menaxhimin e riskut. Masa të kufizuara merren vetëm pasi devijimet të kenë ndodhur.

Ndarja e qartë e detyrave dhe përgjegjësi nuk duket të jetë e mirë. Informimi dhe komunikimi i stafit me menaxhmentin duhet të jetë shumë më aktiv sesa që është aktualisht. Qasja e raportimit të brendshëm, duke përfshirë edhe raportimin financiar duhet ndryshuar. Menaxherët duhet të mbahen të informuar për të gjitha aktivitetet operative, sfidat dhe problemet, në mënyrë që të marrin masa preventive për të parandaluar parregullsitë apo masa përmirësimi për veprimet që kanë ndodhur. Informatat nga lartë-poshtë dhe anasjelltas duhet të analizohen dhe të kthehen me udhëzimet e duhura se si të vepohet më tutje.

Kontrolli i aktiviteteve duhet të pasohet me politika dhe procedura plotësuese të kontrolleve, në veçanti procesi i prokurimit, të hyrat dhe menaxhimi i pasurive.

Konkluzioni

Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike (KBFP) i referohet sistemeve administrative, menaxheriale dhe buxhetore të cilat mbrojnë interesat e financave publike. Ky dokument inkorporon parimet e menaxhimit financiar dhe kontrolleve, si: pajtueshmërinë me ligjin, menaxhimin e performancës, parimin e vlerës për para dhe ruajtjen e pasurive.

Konkluzioni ynë është se komuna nuk ka arrit të promovoj dhe zbatoj kërkesat e këtij dokumenti si dhe t'i përshtatet mjedisit të saj.

Rekomandimi 7

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Rishikimin e sistemit aktual të kontrollit të brendshëm dhe aty ku janë identifikuar dështimet, të nxirren politika dhe procedura specifike me qëllim përmirësimi të kontrolleve.

7.2 Auditimi i Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka një auditor i cili njëkohësisht është edhe drejtor njësie. Në Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2011, auditori i brendshëm ka planifikuar t'i kryej gjashtë (6) auditime, të cilat i ka përmbushur plotësisht.

Auditimet e kryera për vitin 2011, si objektiv kanë pasur: paranë e gatshme (të imtë), auditimin e buxhetit të Komunës, auditimin e shpenzimeve të një shkolle, auditimin e shpenzimeve të Komunës, auditimin në qendrën për punë sociale si dhe rregullsinë e procesit të prokurimit.

Raportet e finalizuara kanë mbuluar periudhën 2010 dhe 2011. NjAB ka arritur të kryej auditime në pajtim me standardet mbi auditimin e brendshëm. Vlerësimi ynë është se raportet ishin mjaft cilësore dhe menaxhmentit i ofrojnë pasqyrë të mirë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe efektivitetin e tyre, por rekomandimet e auditorit të brendshëm nuk ishin adresuar në tërësi nga komuna.

Komuna e Prizrenit ka të themeluar komitetin e auditimit, i cili gjatë këtij viti ka mbajtur dy takime që ka shqyrtuar raportin e auditorit përgjithshëm dhe auditorit të brendshëm.

Konkluzioni

Shërbimet e auditimit të brendshëm nuk ishin shfrytëzuar sa duhet. Trajtimi i rekomandimeve të auditimit nuk është i kënaqshëm. Gjithashtu, edhe puna e Komitetit të auditimit nuk ka rezultuar me efektet e pritura. Ndryshimet nga viti i kaluar janë gati të pa dukshme.

Auditori i brendshëm nuk kishte trajtuar të hyrat vetjake dhe pasuritë, të cilat duket të jenë fushat më problematike të biznesit.

Rekomandimi 8

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Se funksioni i auditimit të brendshëm do të fuqizohet, Komitetit i auditimit do të jetë më aktiv dhe rekomandimet e auditimit do të zbatohen; dhe
- Se auditimi i brendshëm do të ndjekë më tepër proceset e vitit aktual dhe jo ato të viteve të kaluara si dhe do të fokusohet në fushat me rrezik të lartë, siç janë të hyrat, prokurimi dhe pasuritë.

8 Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Prizrenit

Konkluzionet e përgjithshme

Komuna nuk ka arrit të ndërtoj një strukturë të mirë të qeverisjes. Menaxhmenti i komunës duhet të zhvilloj një qëndrim më pozitiv ndaj kontrolleve të brendshme të organizatës. Monitorimi i kontratave është i mangët dhe i pa mjaftueshëm. Obligimet ndaj raportimeve të rregullta dhe të besueshme, duhet të jenë pjesë e përditshme e aktiviteteve për të gjithë. Aftësitë e stafit dhe përvoja e tyre duhet të jenë pikënisje për ndarjen e detyrave dhe dhënien e përgjegjësive. Trajnimet e rregullta dhe promovimet në baza të performancës, po ashtu duhet të praktikohen.

Komuna aktualisht ka mangësi dhe dobësi të cilat duhet t'i adresoj pa vonesë. Forcimi i komponentëve të KBFP-së, ku përfshihen menaxhimi financiar dhe kontrolli, si dhe auditimi i brendshëm, duhet të jenë objektiva të përhershme të menaxhmentit. Ato duhet të shtrihen në tërë organizatën, dhe secili duhet të ndiej obligimin e përgjegjësive dhe llogaridhënies.

Rekomandimi i përgjithshëm

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që për të përmirësuar performancën e përgjithshme të komunës të siguroj se:

- I tërë stafi i komunës së bashku me menaxherët e kuptojnë relevancën e ligjeve që ndërlidhen me kornizën e KBFP dhe një numër dokumentesh të detyrueshëm të politikave, rregulloreve dhe doracakëve të Thesarit, doracakut të procedurave të MFK dhe një sërë udhëzimesh administrative qeveritare.
- Në veçanti, procedurat e MFK duhet t'i bëhen të qarta të gjithëve dhe të ndiqen nga të gjithë.

Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga SNISA 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);

b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;

c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;

d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinionin e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit të kaluar

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të implementuara	Pjesërisht të adresuar	Të pa adresuara
5. Pasqyrat Financiare	Përgatitja e PVF në pajtim të plotë me Rregullën financiare Nr. 07/2011.			X
6.1 Të hyrat	Të forcoj kontrollet dhe angazhimin në mbledhjen e borxheve të mbetura për të hyrat vetjake.			X
6.1 Të hyrat	Barazimi i të hyrave	X		
6.2.1 Shpenzimet	Procedurat e prokurimit të jenë në pajtim me LPP.			X
6.2.2	Pagat e disa punëtorëve me kontratë, të cilët janë paguar përmes kategorisë për mallra dhe shërbime, të procedohen përmes sistemit të pagave.			X
6.3 Pasuritë	Regjistri gjithëpërfshirës i pasurive.	X		
6.2.3 Subvencionet dhe transferet	Subvencionet dhe transferet të ipen në bazë të kërkesave të vlerësuara dhe kritereve të caktuara.			X
6.4.2	Detyrimet e pa paguara të regjistrohen në regjistrat kontabël.			X
7.1 Sistemet e kontrolleve të Brendshme	Përmirësimi i kontrollit financiar dhe kontrollet e përgjithshme;			X
7.2	Funksionalizimi i NJAB me numër të mjaftueshëm të auditorëve.			X
Totali	10	2	0	8